


BULETINI

Nr. 17 • Viti XIII • 2020 • 01.11.2019-31.05.2020

OPERATOR SISTEMI, TRANSMISIONI DHE TREGU SH.A.
TRANSMISSION, SYSTEM AND MARKET OPERATOR J.S.C.
OPERATOR SISTEMA, PRENOSA I TRZISTA, A.D.



PËRMBAJTJA

Praktikat dhe përvoja e menaxhimit të kompanisë në kohën e pandemisë COVID-19	3
Operimi i bllokut të përbashkët Kosovë – Shqipëri	5
Rëndësia e mirëmbajtjes së rrjetit të transmetimit dhe mirëmbajtja në kohë pandemie	8
Bursa e Energjisë Elektrike- APEX (Tregu i bashkuar Shqipëri –Kosovë).....	10
Masat e ndërmarra nga KOSTT në parandalimin e përhapjes së pandemisë COVID-19	11
Vlerësohet angazhimi dhe kontributi i KOSTT në Konferencën I-rë të CIGRE Kosovë	12
Nënshkruhet Marrëveshja Historike për themelimin e Bllokut Rregullues të Sistemeve Energjetike Kosovë-Shqipëri (Blloku AK)	13
Studentët nga Universiteti i Shkencave të Aplikuara Haaga-Helia nga Finlanda vizituan KOSTT sh.a	14
Nënshkruhet Marrëveshja për Kyçje në Sistemin e Transmetimit të Kosovës edhe i një gjeneruesi të energjisë nga burimet e ripërtërishme	14
KOSTT sh.a nënshkruan Memorandum Mirëkuptimi me Operatorin e Sistemit të Transmetimit të Zvicrës-SwissGrid.....	14
Mbahet ligjerata online "Menaxhimi i Burimeve Njerëzore"	14
Menaxhmenti i lartë i Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Zvicrës (SwissGrid) vizitoi KOSTT-in.....	15
Delegacioni nga Ministria e Bashkëpunimit Ekonomik të RF të Gjermanisë dhe KfW vizitoi KOSTT-in	16
Nën moton EachforEqual, disa nga shumë gra të suksesshme të KOSTT flasin për rolin dhe sfidat e gruas në sektorin e energjisë	16
Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT sh.a, priti në takim informues përfaqësuesit e Ambasadave të Quintit, Bashkimit Evropian dhe Zvicrës në Kosovë	17
KOSTT sh.a nënshkruan Memorandum Mirëkuptimi me Operatorin e Sistemit të Transmetimit të Zvicrës-SwissGrid	18
Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT, pjesë e panelit në uebinarin "Zbutja e efekteve të COVID-19 në ndërmarrjet e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Evropën Lindore"	18
Nën moton EachforEqual, disa nga shumë gra të suksesshme të KOSTT flasin për rolin dhe sfidat e gruas në sektorin e energjisë.....	19
Përmbillet me sukses votimi i Marrëveshjes së re të Kyçjes KOSTT/ENTSO-E	25
Kryeministri i Kosovës në detyrë z. Albin Kurti vizitoi KOSTT-in, pas suksesit të arritur me votimin e Marrëveshjes së re të Kyçjes KOSTT/ENTSO-E	26
Ambasadori i Republikës së Shqipërisë z. Qemal Minxhozi vizitoi KOSTT-in	27
Kryetarja e Kuvendit të Kosovës znj. Vjosa Osmani, priti në takim menaxhmentin e lartë të KOSTT, pas suksesit në votimin e Marrëveshjes së re të Kyçjes KOSTT/ENTSO-E	28
Mbahet ligjerata online "Menaxhimi i Burimeve Njerëzore"	29
Menaxhmenti i KOSTT priti në takim përfaqësuesit e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë	29
Mobilizimi i KOSTT në shërbim të sigurisë së furnizimit me energji elektrike dhe luftimin e përhapjes së COVID-19	30

Buletini nr.17, Viti XIII, 2020

Rr. Isa Boletini, Nr. 39, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Buletini është publikim periodik i KOSTT sh.a i cili përgatitet nga Zyra për Komunikim dhe Relacione me Publikun

Për më shumë informacione ju lutemi kontaktoni në:

Tel: +383(0) 38 501 301 174; email: info@kostt.com ose zana.rama@kostt.com

Web: www.kostt.com

Praktikat dhe përvoja e menaxhimit të kompanisë në kohën e pandemisë COVID-19

Me identifikimin e rasteve të para zyrtare të coronavirusit COVID-19 në Kinë, që u raportuan në fund të vitit 2019, dhe tutje përhapjen e tij deri në cilësimin si pandemi nga ana e Organizatës Botërore të Shëndetësisë me datë 11 mars 2020, tashmë i gjithë globi u gjend në një situatë të pashembullt.

Menaxhimi i situatës me përhapjen e virusit, masat e ndërmarra për të parandaluar përhapjen dhe luftimi për ta mposhtur virusin, tashmë ishin fokusi i çdo qeverie dhe i çdo institucioni në mbarë botën. Padyshim, që situata e re tashmë do të ndikonte në çdo aktivitet të njerëzve, në çdo sektor dhe në çdo institucion në të gjithë globin dhe kjo ishte-përballja me pandeminë COVID-19.

Duke e përcjellur në vazhdimësi krizën globale të shëndetit, ne filluam të planifikojmë organizimin e punës dhe stafit në rrethana të pandemisë, kur në mes të muajit mars filloi edhe paraqitja e rasteve të para edhe në Kosovë.

Mbrojtja e shëndetit të punonjësve në njërën anë dhe sigurimi i funksionimit të sigurt të rrjetit të transmetimit si hallkë kyçe për sigurinë e furnizimit me energji elektrike në anën tjetër, tani ishin prioritetet kyçe për ne.

Së bashku me ekipin, i analizuam të gjitha modalitetet e përshtatjes në mënyrë që të sigurohet vazhdimësia e biznesit dhe vendosëm për dy skenare, të cilat do të viheshin në zbatim varësisht nga rrjedha e situatës me pandeminë, me ç'rast punonjësit i informuam me Planin Aksional me datë 13 mars 2020.

Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë, mënyra më e mirë për të parandaluar dhe ngadalësuar përhapjen e coronavirusit COVID-19 është informimi i duhur rreth sëmundjes, që shkakton ajo dhe mënyrën e përhapjes andaj, si hap i parë për të mbrojtur shëndetin e punëtorëve të kompanisë ishin udhëzimet në këtë drejtim.

Për të siguruar funksionimin e sigurt dhe stabil të sistemit të transmetimit dhe operimin e tregut të



Ilir M. Shala, Kryeshef Ekzekutiv

energjisë elektrike, në përputhje me kërkesat dhe rekomandimet e insitucioneve shtetërore dhe shëndetësore për parandalimin e përhapjes së virusit COVID-19, me 15 mars 2020 lansuam Planin për Riorganizimin e Punëve dhe Stafit me të cilin:

- U ndërmorën masat e nevojshme për të mbrojtur shëndetin e punonjësve në detyrë në ambientet e brendshme të punës dhe në terren, duke i furnizuar me pajisje mbrojtëse higjienike si dhe duke dezinfektuar të gjitha hapësirat e punës në KOSTT,
- U ndërmorën masat e nevojshme për të garantuar punën 24/7 të Qendrës Nacionale Dispečerike dhe të 38 Nënstacioneve të KOSTT në mbarë Kosovën. Për të ulur mundësitë e kontakteve të shpeshta, puna e dispečerëve u organizua me ndërrime 24 orëshe,
- U organizuan ekipet kujdestare për intervenimet e nevojshme në terren si dhe për funksionet esenciale u organizua puna me ndërrime në hapësirat zyrtare dhe gjithashtu u organizua edhe puna nga shtëpia.

Në këtë situatë të ndjeshme, përveç tjerash u ndërmorën masa edhe ndaj rreziqeve të mundshme nga ndonjë sulm eventual kibernetik.

Si udhëheqës i KOSTT-it, kisha përgjegjësi institucionale, por edhe njerëzore e kolegjiale që të jem në çdo rast dhe moment pranë punonjësve që situatën me COVID-19 ta menaxhojmë në mënyrën më të mirë të mundshme dhe që në fund të kemi sa më pak raste apo edhe asnjë rast të infektuar tek punonjësit tanë.

I dhash detyrë vetës që këtë kohë pandemie, duhet të tregoj lidhshp të vertetë dhe të sinqert;

- të emetoj më shumë pozitivitet tek të gjithë punonjësit,
- më shumë qetësi, meqë punonjësit tanë, klientët dhe furnitorët tanë do të kërkojnë nga unë si udhëheqës për të projektuar një ndjenjë qetësie në këtë situatë të vështirë dhe të pasigurt;
- besim, meqë duhej të projektoja vetëbesim se do të jem në gjendje të shoh tejkalim të suksesshëm të situatës, me një sasi minimale të dëmit për kompaninë, por edhe për të gjithë palët e interesuara që janë mbështetur në udhëheqjen tonë për të marrë atë besim në ditët më të vështira dhe muajt përpara,
- të komunikoj sa më shpesh me punonjësit tanë, meqë duhet shmangur thashethemet, që mund të zhvillohen. Heshtja është absolutisht gjëja më e keqe e mundshme që mund të ndodhte, sepse kjo është kur thashethemet edhe zhvillohen më shumë;
- të bashkëpunoj edhe më shumë, meqë duhej të bazohem në burimet, aftësitë e të gjithë punonjësve, të gjithë anëtarëve të ekipit tim, dhe t'i bashkoj ata në definimin e detyrave, nën-detyrave dhe potencialisht të ketë vend për të gjithë, që ata mendojnë se mund kontribuojnë në tejkalimin e pasigurisë, tejkalimin e krizës. Angazhimi i punonjësve në këtë mënyrë gjithashtu do të zvogëlojë atë amulli, do t'u japë besim atyre që ata më pas do të projektojnë me radhë tek njerëzit që janë mbështetur tek ata si menaxherët e tyre.
- të tregoj dhembshuri dhe solidaritet, meqë duhet dëgjuar dhe vepruar për rastet, kur shprehin shqetësimet e tyre për COVID-19. Pra, duhej të mendonim edhe për rastet në ndërmarrjen tonë, që kanë prindër të moshuar në një gjendje të brishtë shëndetësore. Ata do të shqetësohen dyfish për të

afërmit në këtë kohë kur virusi po prek potencialisht më të prekurit dhe të sfiduarit mjekësorë. Nëse ata duan pushim, nëse duan të punojnë nga shtëpia, nëse duhet të kenë pak hapësirë për t'u kujdesur për familjarët e tyre, vepruam sipas kësaj logjike dhe ua mundësuam atë.

- Paraja është mbret në një kohë krize dhe gjithçka duhet të bëhet për të parë si afatshkurtër ashtu edhe afatgjatë në shëndetin financiar të organizatës. Në fund të fundit, punonjësit tanë, furnitorët dhe klientët varen nga lidhshpi ynë për të udhëhequr, jo vetëm emocionalisht, por edhe me kujdes në lidhje me financat afatgjata të organizatës. Në këtë kontekst, me sukses, kemi arritur të menaxhojmë edhe financat e ndërmarrjes.

Nga java e parë e muajit maj, sipas rekomandimeve të institucioneve shëndetësore, gradualisht filluan lehtësimet dhe kthimi gradual në normalitet por gjithnjë me masat mbrojtëse të mbajtjes së distancës sociale, mbajtjes së maskës dhe pastrimin apo dezinfektimin e duarve.

Duke marrë parasysh rëndësinë që ka mirëmbajtja preventive e sistemit të transmetimit për të siguruar shkallë të lartë të disponueshmërisë dhe besueshmërisë së rrjetit transmetues, në këtë kohë rikthyem edhe zbatimin e Planit të Mirëmbajtjes, por gjithnjë në respektim të masave mbrojtëse adekuate.

Deri në mes të muajit Qershor, me kënaqësi e potencoj që KOSTT ka arritur të menaxhojë rrjedhën e punës me sukses në të gjitha aspektet. Deri në këtë moment, asnjë punonjës i kompanisë nuk është infektuar me coronavirus dhe funksionimi i Sistemit të Transmetimit dhe i Tregut të Energjisë Elektrike ka rrjedhur pa ndonjë sfidë madhore. Virusit ende është aktiv në mbarë botën, por situata në shumicën e shteteve është nën kontroll, derisa po punohet intenzivisht për gjetjen e vaksinës që do të shpëtonte njerëzimin nga ky armik i padukshëm.

Dua të shtoj edhe këtë se edhe pse kohë pandemie me COVID-19, kemi arritur me sukses të arrijmë aprovimin e Marrëveshjes së re të Kyçjes KOSTT – ENTSO-E, aprovuar me votë nga anëtarët e RGCE/ENTSO-E më 20.04.2020 me: 22 vota Për, 4 Abstenime dhe 3 vota Kundër.

Operimi i bllokut të përbashkët Kosovë – Shqipëri

Roli i operatorit të sistemit (OST) është operimi i sistemit transmetues në mënyrë të sigurt 24 orë gjatë tërë vitit d.m.th. 365 ditë si dhe mirëmbajtja dhe zhvillimi i sistemit transmetues.


Për të operuar sistemin në mënyrë të sigurt operatori i sistemit duhet ta monitoroj dhe kontrolloj disponueshmërinë e sistemit dhe të bëjë balancimin e sistemit në kohë reale. Përmes balancimit të sistemit në kohë reale garantoher që gjenerimi dhe konsumi janë në ekuilibër dhe kështu garantoher mbajtja e frekuencës së sistemit brenda kufijve të lejuar. Për këtë qëllim të gjitha OST-të që operojnë si zona rregulluese në kuadër të Evropës kontinentale janë përgjegjëse për balancimin e zonës së tyre dhe duhet të operojnë në mënyrë të koordinuar me zonat rregulluese fqinje dhe në kuadër të Evropës kontinentale që si tërësi përbëjnë zonën sinkrone.

Pra zona rregulluese është një pjesë koherente e sistemit interkonektiv që operohet nga një operator i vetëm i sistemit dhe ka për detyrë balancimin e sistemit në atë zonë.

Në vazhdimësinë e ndryshimeve të rregullativës Evropiane për sektorin e energjisë që kanë për qëllim dekarbonizimin e sistemit elektroenergjetik, balancimi i sistemit është një komponentë shumë e rëndësishme për të mundësuar integrimin e burimeve të renovueshme të energjisë. Për këtë qëllim me qëllim të balancimit me të lehtë të sistemit, Kodi i operimit të sistemit i njohur si SOGL (System Operation Guideline) dhe Kodi i balancimit janë avancuar shumë në aspektin e shkëmbimit dhe ndarjes së rezervave rregulluese si ndërmjet zonave po ashtu edhe ndërmjet blloqeve rregulluese.

Për balancimin e sistemit në një zonë rregulluese, operatori i sistemit përdor rezervat rregulluese të sistemit siç janë:

1. Rezerva e kontrollit të frekuencës-FCR (Frequency Containment Reserve ose rezerva primare),



Kadri Kadriu, Zv.Kryeshef Ekzekutiv

2. Rezerva e restaurimit automatik të frekuencës - aFRR (Automatic Frequency Restoration Reserve),
3. Rezerva e restaurimit manual të frekuencës - mFRR (Manual Frequency Restoration Reserve)
4. Rezerva zëvendësuese - RR (Replacement Reserve)

Këto rezerva ndihmojnë operatorin e sistemit për të balancuar sistemin në kohë reale në rastet kur gjenerimi dhe konsumi janë në jobalance për shkak të planifikimit jo adekuat, rënjes së njërive nga puna, rënjes së papritur të ngarkesës etj. Aktivizimi i këtyre rezervave nga aspekti kohor është i ndryshëm.

KOSTT si Operator Sistemi Transmisioni dhe Tregu në Kosovë në kuadër të Evropës kontinentale është në proces të Marrëveshjes së re të Kycjes me OST-të e Evropës kontinentale. Me hyrjen në fuqi të Marrëveshjes së Kycjes, KOSTT bëhet zonë rregulluese (LFC area) e pavarur në kuadër të Bllokut rregullues Kosovë - Shqipëri i njohur si blloku AK. Për shkak të mosnjohjes së KOSTT si zonë rregulluese në kuadër të Evropës kontinentale, KOSTT nuk ka bërë alokimin e kapaciteteve ndërkufitare të Kosovës me vendet fqinje dhe rrjedhimisht edhe mbledhjen e të

hyrave nga alokimi i kapaciteteve. Po ashtu deri në vitin 2016 KOSTT nuk ka mbledhur të hyrat nga transiti i energjisë nëpër rrjetin transmetues të Kosovës. Bllokimi i operimit të KOSTT si zonë rregulluese nga pala Serbe ka shkaktuar kosto të larta në sistemin elektroenergjetik të Kosovës në përgjithësi. Përveç asaj që u tha me lart si pasojë e mos implementimit të Marrëveshjes së parë të Kyçjes KOSTT/ENTSO-E e cila ishte nënshkruar në vitin 2015 janë edhe devijimet e sistemit interkonektiv. Operimi në rrethana të tilla ka bërë që KOSTT të ketë vështirësi të mëdha të balancimit të sistemit.

Që nga viti 2014 kur është arritur Marrëveshja për energji ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, KOSTT ka bërë përpjekje maksimale që statusi i operimit të KOSTT në kuadër të Evropës kontinentale të ndërrohet dhe Marrëveshja e Kyçjes e nënshkruar në vitin 2015 të futet në fuqi në mënyrë që KOSTT të operoj si bllok rregullues i pavarur. Kjo nuk ka qenë e mundur për shkak të obstrukcioneve të palës serbe në ENTSO-E. Në prill të vitit 2020 është votuar Marrëveshja e re e Kyçjes e cila pritet të hyjë në fuqi në vjeshtë 2020. Deri në votimin e Marrëveshjes së re të kyçjes janë bërë shumë aktivitete të rëndësishme që kanë kontribuar që KOSTT të dëshmojë se do të përmbush obligimet që rrjedhin nga kjo marrëveshje. Këto obligime janë kërkesa të marrëveshjes së re SAFA dhe kodeve të rrjetit.

Me qëllim të operimit ekonomik të sistemit në kuadër të Evropës janë zhvilluar kodet e rrjetit që lejojnë OST-të të organizohen në grupe më të mëdha që d.m.th. të themelojnë blloqe ku disa OST bashkërisht mund të optimizojnë rezervat e rregullimit të sistemit. Qëllimi i krijimit të bllokut është operimi dhe balancimi me i lehtë i sistemit, zvogëlimi i kostove të rezervës së sistemit.

Keshtu KOSTT dhe OST Shqipëri kanë analizuar operimin e dy sistemeve perkateses dhe kanë bërë disa studime në lidhje me përfitimet ekonomike të operimit të dy OST-ve në kuadër të bllokut të përbashkët. Pas një pune shume intensive dhe një

bashkëpunimi efikas ndërmjet KOSTT dhe OST me date 26 nëntor u nënshkrua Marrëveshja e themelimit të Bllokut Kosovë-Shqipëri, i njohur si Blloku AK. Blloku AK do të përbëhet nga dy zona rregulluese KOSTT-OST. Marrëveshja është përgatitur nga të dy OST-të dhe është aprovuar nga rregullatorët përkatës të vendeve tona. Marrëveshja e bllokut është dërguar Grupit Regjional të Evropës Kontinentale (RGCE) për aprovim. RG CE në mbledhjen e mbajtur në dhjetor të vitit 2019 e ka konsideruar si hap të rëndësishëm për sigurinë e sistemit themelimin e këtij blloku.

Sipas studimeve të bëra operimi në kuadër të bllokut AK për të dy OST-të sjell përfitime ekonomike. Përfitimet ekonomike janë rezultat i dimensionimit të përbashkët të rezervave, shkëmbimit të rezervave dhe ndarjes së rezervave ndërmjet dy OST-ve.

Blloku i përbashkët AK ka qenë një projekt i filluar më herët por që është konkretizuar tani. Për këtë qëllim për të jetësuar themelimin e bllokut të përbashkët janë bërë investime gjatë ndërtimit të linjës 400kV Kosovë-Shqipëri. Në vitin 2016 është komisionuar projekti LFC (Load frequency control) ndërmjet KOSTT dhe OST Shqipëri që ka për qëllim shkëmbimin e rezervave të rregullimit automatik, netimin e imbalanceve dhe në fund themelimin e bllokut që mundëson dimensionimin e përbashkët të rezervave.

Përfitimet ekonomike nga dimensionimi i rezervave janë evidente. Nëse të dy OST-të operojnë si blloqe të ndara atëherë secili bllok duhet të disponoj këto rezerva:

- Kosova: mFRR=270MW/-50 MW, aFRR=±35MW
- Shqipëria: mFRR = 150 MW/-50MW, aFRR=±45MW
- Total rezerva e dy blloqeve Kosovës dhe Shqipërisë: mFRR=420MW/-100MW, aFRR=± 80MW

Kurse në një bllok të përbashkët kërkesa për rezervën manuale zvogëlohet dukshëm. Pra rezerva e bllokut të përbashkët është: mFRR= 270MW/-50MW, ku KOSTT do të siguroj kapacitetin prej

197MW dhe OST Shqipëri =73MW. Kështu që rezulton që KOSTT do ta zvogëloj kërkesën për rezervë për 73MW dhe OST=77 MW

Nga ky mode i operimit të dy OST-të do të zvogëlojnë koston e rezervës në baza vjetore prej 4.9 Mil.EUR/vit.


Meqenëse Kosova ka vështirësi në sigurimin e rezervave brenda sistemit për shkak se sistemi i Kosovës ka fleksibilitet të ulët për shkak të dominimit të operimit të njëjësive gjeneruese nga termocentralet atëherë përmes marrëveshjes së bllokut mundësohet qasja në njësitë gjeneruese fleksibile në kuadër të sistemit elektroenergjetik shqiptar pra në hidrocentralet në Shqipëri të cilat kanë fleksibilitet të mjaftueshëm për të dhënë rezerva të sistemit.

Dimensionimi, këmbimi dhe ndarja e rezervave është hapi i parë dhe shumë i rëndësishëm i përfitimeve ekonomike të të dy vendeve. Kjo do të jetë si një udhërrëfyes për bashkëpunim të mëtejshëm në themelimin e Bursës së përbashkët të energjisë (APEX) që dy vendet synojnë ta bëjnë gjatë vitit 2020.

Marrëveshja e Bllokut AK obligon palët të punojnë bashkërisht në operimin e bllokut të përbashkët sipas detyrimeve që rrjedhin nga marrëveshja SAFA

dhe SOGL dhe në harmoni me kodet nacionale të rrjetit. Referuar SOGL, një nga pjesëmarrësit e Bllokut LFC duhet të jetë në rolin e monitorimit të bllokut. Për Bllokun AK monitorues i bllokut është OST Shqipëri. Nisur nga kjo marrëveshje, që të kryhet monitorimi i bllokut, OST do ta ndërtoj skemën e monitorimit të bllokut përfshirë tërë perimetrin e bllokut sipas skemës së dhënë më poshtë. Krahas ndërhyrjeve në sistemin SCADA/EMS të OST është e nevojshme të ndërhyhet nga ana e KOSTT në RTU-të e N/St kufitare duke krijuar një ndërfaqe IEC 60870-5-104 me sistemin SCADA të OST.


Në mënyrë që Blloku AK të mund të kryej detyrimet operative sipas kërkesave të ENTSO-E janë themeluar 5 grupe punuese që kanë punuar procedurat e operimit të Bllokut sipas marrëveshjes. Procedurat e operimit përfshijnë këto procese: monitorimin e bllokut, dimensionimin e përbashkët të rezervave të rregullimit, aktivizimi i rezervave të përbashkëta të rregullimit, operimi i bllokut në situatë emergjente dhe planifikimi afatgjatë i rezervave. Gjatë vitit 2020 me përmbushjet e kushteve teknike nga katalogu i masave KOSTT pritet të filloj operimin si zonë rregulluese dhe paralelisht edhe Blloku AK. Kjo është një e arritur shumë e rëndësishme për Sistemin Elektronergjetik të Kosovës dhe Shqipërisë.



Rëndësia e mirëmbajtjes së rrjetit të transmetimit dhe mirëmbajtja në kohë pandemie

Sistemi elektroenergjetik i Kosovës është një ndër sistemet me rëndësi vitale për funksionimin pothuajse të të gjithë sektorëve tjerë në shoqërinë tonë dhe për këtë rol kyç ka Operatori i Transmetimit të Kosovës, andaj rëndësia e mirëmbajtjes së rrjetit të transmetimit është element i domosdoshëm për të mundësuar furnizim stabil dhe të qëndrueshëm me energji elektrike.

Situata me të cilën po përballemi me Pandeminë COVID-19, na ka obliguar që t'i përshtatemi rrethanave të reja me organizim të ri bazuar në



Pamje nga punimet në linjën interkonektive 400 kV LP 4372 që lidhë Nënstacionin 400/110 kV Peja 3 me NS Ribarevina (Mali i Zi) 1



*Besim Gërzhaliu,
Drejtor i Departmentit, Operatori i Transmisionit*

rekomandimin e Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKSHP) dhe të Ministrisë së Shëndetësisë.

Duke pasur parasysh këtë, janë ndërmarrë veprimet konform situatës së krijuar.

Në fazën e parë të pandemisë janë krijuar ekipet kujdestare të ndara në dy grupe me qëndrim në vendin e tyre të punës vetëm për raste emergjente. Paraqitja e tyre në vendin e punës është organizuar në rotacion.

Në fazën e dytë kujdestaria është mbajtur në shtëpi me ç'rastkipet janë ndarë në tri grupe të pavarura të punës në mënyrë që të evitohet mundësia eventuale e shpërndarjes së virusit ndërmjet stafit të mirëmbajtjes. Gjatë kësaj periudhe janë zhvilluar aktivitete vetëm në raste emergjente apo intervenime preventive të cilat ishin në numër mjaft të vogël. Fatmirësisht gjatë kësaj periudhe nuk kemi pasur ndonjë problem serioz, që është reflektim i punës së mirë në mirëmbajtje si dhe investimeve që kanë ndodhur



Pamje nga punimet në linjën interkonektive 400 kV LP 4372 që lidhë Nënstacionin 400/110 kV Peja 3 me NS Ribarevina (Mali i Zi) 1

ndër vite në sistemin elektroenergetik, duke krijuar kështu siguri dhe besueshmëri të lartë të operimit të rrjetit të transmetimit. Gjatë kësaj kohe kemi pasur disa intervenime në nënstacione të ndryshme si dhe remontin e një linje interkonektive 400 kV.

Faza e tretë ka filluar me datë 04.05.2020 dhe krahas menaxhimit me pandemi, paralel do të zhvillohen edhe aktivitetet në realizimin e planit të mirëmbajtjes.

Duke pasur parasysh këtë, është bërë një riorganizim ku është planifikuar mirëmbajtja e rregullt e aseteve bazuar në Planin Vjetor të Mirëmbajtjes për vitin 2020, duke respektuar procedurat e njejta për shkyqje dhe mirëmbajtje.

Në këtë periudhë është planifikuar që stafi i mirëmbajtjes nga secili sektor të ndahet në dy grupe punuese të angazhuara ndaras në aktivitetet në teren me qëllim të respektimit sa më rigoroz të masave kundër COVID-19 dhe njëkohësisht rritjen e efikasitetit në punë me qëllim të realizimit të planit të mirëmbajtjes. Kjo ka qenë e mundur falë numrit të mjaftueshëm të stafit të rekrutuar në dy vitet e fundit të cilët tani më janë të gatshëm t'i marrin përgjegjësite në

vendin e punës. Këtu duhet cekur që përveç stafit të mjaftueshëm dhe profesional, KOSTT posedon të gjitha pajisjet dhe makineritë e nevojshme për të realizuar të gjitha aktivitetet e planifikuara për mirëmbajtje.

Në fund mirënjohje dhe falënderim i veçantë shkon për gjithë stafin e mirëmbajtjes të cilët me përkushtimin, vullnetin dhe profesionalizmin kanë dhënë kontribut të çmueshëm në realizimin e objektivave të KOSTT.



Pamje gjatë punimeve për largimin e materialeve të bartura nga shpendët në stabilimentet e tensionit 220 kV, fusha e largpërcuesve LP 205/1 dhe LP 267 në NS 400/220 kV Kosova

Bursa e Energjisë Elektrike- APEX (Tregu i bashkuar Shqipëri –Kosovë)

I. HYRJE

Kosova dhe Shqipëria si Palë Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë obligohen të përmbushin objektivat nga Pakoja e Tretë e Bashkimit Evropian (BE) për liberalizimin e sektorit të energjisë në veçanti objektiven mbi Modelin e Synuar të tregut të energjisë elektrike me shumicë dhe janë zotuar ligjërisht për të liberalizuar, derregulluar dhe integruar tregjet e tyre të energjisë elektrike si hap drejt Tregut të Brendshëm Evropian të Energjisë Elektrike ("IEM"). Gurë themel i këtij synimi të shumëfishtë është krijimi, operacionalizimi dhe bashkimi i tregjeve të organizuara ditore (DAM). Në Samitin e Ballkanit Perëndimor, të mbajtur në Vjenë më 27 Gusht 2015, shtetet e Ballkanit Perëndimor vendosën të krijojnë operatorë (bursa të energjisë elektrike) për operimin dhe rrjedhimisht bashkimin e tregjeve DAM në një treg rajonal, krijimin e një tregu balancues ndërkufitar si dhe të vënë në shfrytëzim Zyrën për Ankand të Koordinuar për alokimin e kapaciteteve ndërkufitare, që tashmë ekziston si SEE CAO.

Mbi këtë bazë OST dhe KOSTT në bashkëpunim me ERE dhe ZRrE (autoritete rregullatore të Shqipërisë dhe Kosovës) dhe me mbështetje të qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës, janë pajtuar për themelimin e bursës së përbashkët të energjisë elektrike si hap i parë drejt integritimit në tregun e integruar Evropian, IEM.

II. KARAKTERISTIKAT E TREGUT TË BASHKUAR (APEX)

Kosova dhe Shqipëria, janë tregje të vogla dhe jolikuide ku ka mungesë të divergjencës të kapaciteteve gjeneruese dhe varësi nga importi i energjisë elektrike nga tregu rajonal jo-likuid dhe jo transparent. Kompanitë e tanishme në të dy vendet karakterizohen nga një jo-efikasitet i lartë dhe shfrytëzim jo-optimal i burimeve prodhuese.

Aktualisht Kosova ka njësi gjeneruese jo-fleksibile (mbi 90 % e prodhimit është e bazuar në linjit) dhe të



*Skender Gjonbalaj,
Drejtor i Departmentit të Operimit të Tregut*

pamjaftueshme për të mbuluar kërkesën gjithnjë në rritje të konsumit. Kapacitetet prodhuese në Shqipëri mbi 95% janë me bazë hidrike. Si rezultat, prodhimi i energjisë elektrike në Shqipëri dhe siguria e furnizimit varen shumë nga kushtet hidrike e kryesisht në sezonet e thata.

Kosova dhe Shqipëri kanë ndërlidhje të fortë me linja ndërkufitare transmetuese me kapacitet të disponueshëm transmetues në vlerë rreth 800MW. Po ashtu edhe Kosova edhe Shqipëria ndërlidhen me shtetet fqinje me linja ndërkufitare me kapacitet të disponueshëm transmetues me vlerë mbi 600MW me secilin shtet.

III. PROCESAT KRYESORE OPERATIVE TË BURSËS SË ENERGJISË ELEKTRIKE (APEX)

APEX do të operoj njëkohësisht si treg i organizuar DAM dhe si treg i bashkuar Kosovë- Shqipëri për të siguruar likuiditet dhe konkurrencë dhe do të aplikoj ankand implicit të kapaciteteve ndërkufitare, që tashmë është në zbatim në shumicën e tregjeve Evropiane.

APEX ka për qëllim bashkimin e tregut DAM të energjisë elektrike në Shqipëri dhe Kosovë në mënyrë efikase dhe me kosto efektive dhe bashkimin e tyre me tregun rajonal.

Organizimi i ankandeve në APEX do të organizohet nga një operator i tregut me përvojë Evropiane (Sistemi operativ i Bursës së Energjisë) si Ofruesi Shërbimi për APEX. Kjo do të thotë që Ofruesi i Shërbimit do të sigurojë platformën e tregtimit (sistemi elektronik i tregtimit), algoritmin dhe llogaritjen (çmim-formësim, volumit të energjisë ...).

Për nevoja operative të bashkimit të tregut, APEX do të krijoj degën e APEX në Kosovë. Ndërmarrja degë do të jetë një entitet juridik i regjistruar në Kosovë përgjegjës për marrëdhëniet me Palët Tregtare në Kosovë. Kjo degë do të jetë përgjegjëse për të gjitha çështjet administrative, tatimore dhe doganore në përputhje me kornizën ligjore të Kosovës.

APEX si treg i organizuar, do të ofrojë shërbimet e mëposhtme të:

- Tregut e një dite përpara – tregut të ditës në avancë (DAM);
- Tregut brenda ditës (IDM);
- Tregtimit të produkteve të veçanta (PS);
- Bashkimit të Tregut (MC).

IV. Benifitet nga APEX

APEX do të sigurojë sinjale të nevojshme për investimet e ardhshme në prodhimin e energjisë elektrike në Kosovë dhe Shqipëri, për investimet në rrjetet e transmetimit të energjisë elektrike dhe shfrytëzimin më efikas të burimeve ekzistuese nga ana tjetër.

APEX duke pasur parasysh karakteristikat komplementare të tregut në Kosovë dhe Shqipëri do të ofroj:

- Treg konkurrues, transparent dhe çmim më të lirë të energjisë elektrike
- Shfrytëzim optimal të burimeve prodhuese
- Shfrytëzim optimal të kapaciteteve ndër-kufitare transmetuese

Masat e ndërmarra nga KOSTT në parandalimin e përhapjes së pandemisë COVID-19

S sektori për Siguri, Shëndet dhe Mjedis (SShM) funksionon dhe operon brenda Departamentit të Burimeve Njerëzore, duke pasur përgjegjësinë për të gjitha zhvillimet dhe implementimet e politikave të sigurisë, shëndetit dhe mjedisit sipas standardeve OHSAS 18001 (ISO 45001) dhe ISO 14001.

Sektori SShM zhvillon dhe implementon program të vetëdijësisimit për siguri, shëndet dhe mjedis për punëtorët e KOSTT si dhe siguron përgatitjen dhe zbatimin e planeve për inspektim në teren mbi zbatimin e masave të sigurisë dhe shëndetit në punë dhe mbrojtjen e mjedisit në objekte elektro-energjitike, gjatë procesit të mirëmbajtjes së rrjetit dhe riparimit nga ekipet e KOSTT si dhe gjatë implementimit të projekteve nga kontraktuesit.

Që nga data 11 mars 2020 fokusi kryesor ka qenë marrja e masave për parandalimin e përhapjes së pandemisë Covid-19 si dhe menaxhimi i sigurimit



Xhafer Arifi, Menaxher i Sektorit Siguria, Shëndeti dhe Mjedis

shëndetësor të punëtorëve, asistimi i punëtorëve në çështjet e mbulimit të sigurimeve shëndetësore dhe problemet e ndërlidhura me këtë çështje.

Me shpalljen e pandemisë Covid-19 nga Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH), KOSTT ka ndërmarrë masat paraprake për parandalimin e përhapjes së pandemisë dhe ruajtjen e shëndetit të punëtorëve. Janë përgatitur dy skenar për organizimin e stafit dhe procesit të punës për ti vënë në zbatim në rast të paraqitjes së virusit dhe kufizimit të lëvizjes.

Spektori SShM që nga fillimi i paraqitjes së virusit ka qenë dhe është në kontakt të vazhdueshëm me Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike (IKSH) për marrjen e informacioneve rreth masave të cilat duhet të zbatohen nga punëtorët. Me këtë rast që në ditët e para janë ndërmarrë një sërë masash.

E menjëhershme ka qenë vendosja e panove në të cilat janë të përshkruara masat për parandalimin e infeksionit me Covid 19, të cilat janë vendosur në vende më të frekuentuara nga punëtorët e KOSTT-it. Furnizimi me dezinfektues për secilën zyre, pajisja e të gjithë punëtorëve me maska mbrojtëse si dhe me dorëza njëpërdorimëshe.

Bazuar në vendimin e Qeverisë së Kosovës nr.01/07 të dt.11.03.2020 për dezinfektimin e objekteve, menjëherë me datë 12.03.2020 sektori SShM ka filluar dezinfektimin e të gjitha hapësirave të objekteve dhe ka vazhduar në baza javore.



KOSTT

Vlerësohet angazhimi dhe kontributi i KOSTT në Konferencën e I-rë të CIGRE Kosovë

Në kuadër të konferencës së parë që u organizua në Prishtinë nga Komiteti Nacional i CIGRE Kosovë, pjesë e Asociacionit ndërkombëtar për sistemet e mëdha elektrike CIGRE (International Council on Large Electric Systems) me seli në Paris, Kryeshefi ekzekutiv i KOSTT z.Illir M.Shala pranoi mirënjohje si një nga mbështetësit më të mëdhenj të kësaj organizate profesionale.

Në kuadër të konferencës që u zhvillua nga data 6-8 Nëntor 2019, ekspertë të fushave energjetike nga



CIGRE



CIGRE

KOSTT prezentuan punimet e tyre si dhe ishin pjesë e paneleve ku u diskutuan tema të rëndësishme në sektorin e energjisë me fokus në integrimin e burimeve të renovueshme të energjisë në sistemin energjetik si dhe politikave të sektorit të energjisë elektrike.

Në konferencë morën pjesë rreth 200 pjesëmarrës, ekspertë të fushës së energjisë nga vendi, rajoni dhe Evropa.

Nënshkruhet Marrëveshja Historike për themelimin e Bllokut Rregullues të Sistemeve Energjetike Kosovë-Shqipëri (Blloku AK)

Pas një pune shumë intensive dhe një bashkëpunimi efikas ndërmjet Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të energjisë elektrike të Kosovës (KOSTT) dhe Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Shqipërisë OST, me 26 Nëntor 2019, në Tiranë u nënshkrua Marrëveshja e themelimit të Bllokut Rregullues të Sistemeve Energjetike Kosovë-Shqipëri (Blloku AK).



Operimi si Bllok Rregullues i përbërë prej dy zonave rregulluese KOSTT dhe OST, ka për qëllim operimin më të lehtë të dy sistemeve elektroenergjetike si nga aspekti teknik ashtu dhe ai ekonomik. Kjo do të mundësojë operimin dhe balancimin më të lehtë të dy sistemeve, zvogëlimin e kostove dhe shkëmbimin e rezervave të sistemeve.

Marrëveshja në fjalë është nënshkruar, në dijeni të ENTSO-E, me pëlqimin e dy rregullatorëve nacionalë të energjisë ZRrE (Kosovë) dhe ERE (Shqipëri). Kjo marrëveshje është parakusht për operimin e pavarur të KOSTT-it dhe parashihet të hyjë në fuqi, pas nënshkrimit dhe fillimit të implementimit të Marrëveshjes së re të Kyçjes në mes të KOSTT dhe ENTSO-E.

Marrëveshja është po ashtu në përputhje me kërkesat e reja të Kodit të Rrjetit të ENTSO-E që ka për



qëllim promovimin e bashkëpunimit të OST-ve (Operatorët e Sistemit të Transmetimit) në funksion të operimit të sigurt të Sistemeve Energjetike si dhe minimizimit të kostove të operimit.

Me këtë, fillon bashkëpunimi i parë konkret i shkëmbimit të rezervave në kuadër të dy tregjeve energjetike Kosovë-Shqipëri me synimin e mëtejme për jetësimin e Bursës së përbashkët të energjisë (APEX) në kuadër të së cilës do të mundësohet që edhe palët e tjera tregtare të bëhen pjesë e bursës që do të themelohet së shpejti.

Me rastin e nënshkrimit të marrëveshjes, Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z.Illir M. Shala theksoi se kjo është marrëveshje historike për Kosovën dhe KOSTT-in, meqë deri më tani ne si KOSTT kemi qenë brenda Zonës Rregulluese serbe (EMS), gjegjësisht brenda bllokut rregullues SMM (Serbi, Mali i Zi dhe Maqedoni e Veriut) dhe tani me nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje me OST (Shqipëri) dhe fillimin e implementimit të saj në prill të vitit 2020, definitivisht shkëputemi nga ombrella e Zonës Rregulluese serbe EMS dhe bëhemi pjesë e Bllokut Rregullues me OST Shqipëri, ku me implementimin e kësaj marrëveshje rritet dhe garantohet siguria e operimit dhe balancimit të sistemit elektro-energjetik të Kosovës, sipas standardeve të kërkuara nga ENTSO-E.

z.Skerdi Drenova, Administratori i përgjithshëm i OST theksoi se krijimi i Bllokut të Kontrollit "OST-KOSTT" garanton sigurinë e operimit për të dy Sistemet Elektroenergjetike dhe krijon kushte të favorshme për shfrytëzimin optimal të burimeve gjeneruese brenda Bllokut."

Studentët nga Universiteti i Shkencave të Aplikuara Haaga-Helia nga Finlanda vizituan KOSTT sh.a

Duke përdorur një qasje unike arsimore që lëviz përtej leksioneve në klasë, një grup studentësh të Universitetit të Shkencave të Aplikuara Haaga-Helia nga Finlanda në krye me profesorin e biznesit ndërkombëtar Dr. Evariste Habiyakare vizituan Operatorin e Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës (KOSTT sh.a.).

Përmes prezantimeve të ndryshme nga ekspertë të fushës, studentët patën mundësi të informohen për veprimtarinë dhe rolin e KOSTT në sektorin e energjisë në Kosovë, zhvillimin e tregut, të ardhmen e industrisë energjetike si në Kosovë ashtu edhe në spektrin global,

kulturën e të bërit biznes në sektorin e energjisë në Kosovë si dhe qasjen ndaj publikut në këtë drejtim.

Me këtë rast, Alban Imeri-Drejtor i Departamentit për Zhvillim të Rrjetit dhe Projekteve në KOSTT së bashku me bashkëpunëtorët, falënderuan Dr. Evariste Habiyakare dhe studentët pjesëmarrës për interesimin që kanë shprehur për t'u njohur për së afërmi me veprimtarinë e KOSTT dhe zhvillimet aktuale në sektorin e energjisë, ndërsa të rinjtë nga Finlanda u ndanë shumë të kënaqur me mikpritjen si dhe me informacionet që morën në kuadër të vizitës që zhvilluan.



Nënshkruhet Marrëveshja për Kçje në Sistemin e Transmetimit të Kosovës edhe i një gjeneruesi të energjisë nga burimet e ripërtërishme

Në vazhden e përkrahjes dhe krijimit të mundësive për diversifikimin e burimeve të energjisë elektrike në vend, me 13 dhjetor 2019 Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT sh.a z. Ilir M. Shala dhe Drejtori i BondCom z. Enver Cacaj nënshkruan Marrëveshjen për Kçje në Sistemin Transmetues të Kosovës, të Parkut energjetik me erë "Budakova".

Ky Park energjetik do të kçjet në rrjetin e tensionit të lartë 110 kV si dhe do të ketë kapacitet të instaluar gjenerues prej 46 MW.

Pas shqyrtimit të aplikacionit nga KOSTT dhe nënshkrimit të Marrëveshjes për Kçje në Sistemin Transmetues, Parku Energjetik me erë "Budakova" do të ndërtohet në Komunën e Therandës dhe pritet që të fillojë me gjenerimin e megavatëve të parë në fund të vitit 2022.



Në harmoni me objektivat e Strategjisë shtetërore të Energjisë 2017-2026, investimet e vazhdueshme të cilat i ka realizuar KOSTT në Sistemin e Transmetimit gjatë dekadës së fundit, kanë krijuar kushte të favorshme për akomodimin e kapaciteteve të reja gjeneruese të energjisë elektrike dhe njëherit përkrahjen e integritetit të burimeve të ripërtërishme në rrjetin transmetues.

Menaxhmenti i lartë i Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Zvicrës (SwissGrid) vizitoi KOSTT-in

Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z. Ilir M. Shala me bashkëpunëtorë, me 13 Janar 2020 pritën në vizitën e parë të realizuar në Kosovë menaxhmentin e lartë të Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Zvicrës (SwissGrid) në krye me Kryeshefin Ekzekutiv z. Yves Zumwald.

mentimi i së cilës gjithashtu do të fillojë me përfundimin e proceseve të lartcekura.

Në anën tjetër, Kryeshefi Ekzekutiv i SwissGrid z. Yves Zumwald e shprehi mbështetjen e tij për KOSTT drejt integritimeve në mekanizmat



KOSTT

Në kuadër të takimit, delegacioni zviceran u njoftua me rezultatet dhe sukseset në KOSTT si dhe me zhvillimet drejt integritimeve në mekanizmat ndërkombëtar të fushës së energjisë elektrike.

Kryeshefi Ekzekutiv z. Shala me këtë rast potencoi përkushtimin e palëkundur të KOSTT për nënshkrimin e Marrëveshjes së re të Këqjes me ENTSO-E dhe fillimin e operimit të pavarur brenda Zonës Sinkrone të Evropës Kontinentale, sipas afatit të paraparë nga RGCE/ENTSO-E (Grupi Regjional i Evropës Kontinentale në kuadër të ENTSO-E), 14 Prill 2020. Në këtë drejtim të pranishmit, gjithashtu, u njoftuan edhe me zhvillimet më të reja sa i përket Nënshkrimit të Marrëveshjes për themelimin e Blllokut Rregullues Kosovë-Shqipëri, imple-

ndërkombëtarë si operator i sistemit të transmetimit i ndërlidhur me rrjetin evropian të energjisë elektrike si dhe theksoi rëndësinë, që ka zgjidhja e sfidave, me të cilat përballlet KOSTT në drejtim të ndërprerjes së devijimeve/tërheqjes së energjisë nga Sistemi Elektroenergjetik i Evropës Kontinentale.

Swissgrid si anëtar aktiv i Rrjetit të Operatorëve Evropianë të Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike (ENTSO-E), gjithashtu mban rolin e Qendrës Koordinuese, e cila përfshin Francën, Spanjën, Portugalinë, Italinë, Austrinë si dhe vendet e Evropës Juglindore, duke përfshirë dhe Kosovën.

Të dy udhëheqësit e kompanive simotra u dakorduan në thellimin e bashkëpunimit të mëtutjeshëm në mes të KOSTT dhe Swissgrid.

Delegacioni nga Ministria e Bashkëpunimit Ekonomik të RF të Gjermanisë dhe KfW vizitoi KOSTT-in

Zv.Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z.Kadri Kadriu me bashkëpunëtorë, me 24 Janar 2020 pritën në takim delegacionin gjerman në krye me zyrtares e lartë përgjegjëse për Kosovën nga Ministria e Bashkëpunimit Ekonomik të Republikës Federale të Gjermanisë znj. Michala Brinkhaus e cila ishte e shoqëruar edhe nga zyrtarë të lartë nga Ambasada Gjermane në Kosovë dhe Banka Gjermane për Zhvillim-KfW.



KOSTT

Duke i falënderuar për kontributin e vazhdueshëm financiar të Qeverisë Gjermane përmes KfW në zhvillimin e Sistemit të Transmetimit të Kosovës, z.Kadriu i njoftoi të pranishmit për rëndësinë dhe benefitet e këtyre investimeve në sigurinë e furnizimit me energji elektrike dhe mirëqenien e qytetarëve të Republikës së Kosovës.

z.Kadriu gjithashtu foli rreth sfidave me të cilat përballet KOSTT në drejtim të integritimit në mekanizmat Evropian të Sistemeve Elektro-energjetike, dhe angazhimet që po bëhen në drejtim të avancimit të KOSTT në këtë drejtim.

Në kuadër të takimit, z. Gazmend Kabashimenaxher i zyrës për zhvillim dhe planifikim afatgjatë prezantoi pasqyrën e Sistemit Elektro-energjetik të Kosovës, kapacitetet e Rrjetit të Transmetimit dhe mundësitë për kyçjen e kapaciteteve të reja gjeneruese duke përfshirë burimet e renovueshme të energjisë elektrike si dhe rolin dhe rëndësinë e Sistemit të Transmetimit të Kosovës në rrjetin e ndërlidhur rajonal dhe atë evropian të energjisë elektrike.

Delegacioni gjerman vlerësoi lartë sukseset e arritura të KOSTT dhe u shpreh i kënaqur me rezultatet nga investimet e realizuara me fondet e Qeverisë Gjermane përmes KfW.



KOSTT

Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT sh.a, priti në takim informues përfaqësuesit e Ambasadave të Quintit, Bashkimit Evropian dhe Zvicrës në Kosovë

Me datë 29 Janar 2020, në ambientet e ndërtesës Qendrore të KOSTT, Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT sh.a z.Illir M. Shala me bashkëpunëtorë, priti në takim informues përfaqësuesit e Ambasadave të shteteve të Quintit në Kosovë (Ambasada e Shteteve të Bashkuara, Ambasada e RF Gjermane, Ambasada Franceze dhe Ambasada e Britanisë së Madhe) përfaqësuesit e Zyrës së Bashkimit Evropian, Ambasadës Zvicerane në Kosovë si dhe përfaqësuesit e institucioneve relevante vendore.

z.Shala, njoftoi pjesëmarrësit për së afërmi në lidhje me rolin e KOSTT në sistemin elektroenergjetik të Kosovës, sfondin e Marrëveshjes së re të Kyçjes me ENTSO-E, statusin dhe hapat e ardhshëm të Marrëveshjes së re të Kyçjes me ENTSO-E si dhe themelimin e Bllokut AK Shqipëri-Kosovë, ku objektivi kryesor i KOSTT është që Marrëveshja e re e Kyçjes të jetë në fuqi më 15 Prill 2020 dhe KOSTT të fillojë funksionimin si



KOSTT

zonë/blok rregullues në kuadër të Evropës Kontinentale, ku pas kësaj KOSTT do të marrë të gjitha përgjegjësitë për të balancuar sistemin dhe për të ndaluar devijimet e paqëllimshme.

z. Shala, po ashtu falënderoi përfaqësuesit e ambasadave të vendeve të Quint-it dhe të gjithë partnerët ndërkombëtarë për mbështetjen e vazhdueshme që po i japin KOSTT-it në fuqizimin e proceseve dhe sensibilizimin e çështjes së operimit të pavarur nga Serbia ku si rezultat KOSTT tashmë me 26 Nëntor 2019 ka nënshkruar Marrëveshjen e themelimit të Bllokut Rregullues të Sistemeve Energjetike Kosovë-Shqipëri (Blloku AK).

Delegacioni diplomatik vlerësoi lartë punën dhe përkushtimin e KOSTT si dhe shprehën mbështetjen e tyre për KOSTT në vazhden e integriteteve rajonale dhe fillimit të operimit të pavarur në kuadër të Bllokut Rregullues të përbërë prej dy zonave rregulluese KOSTT dhe OST Shqipëri.



KOSTT

KOSTT sh.a nënshkruan Memorandum Mirëkuptimi me Operatorin e Sistemit të Transmetimit të Zvicrës-SwissGrid

Në kuadër të angazhimeve në funksion të avancimit të partneriteteve, bashkë-punimit dhe integritimit në mekanizmat ndërkombëtar, me 25 shkurt 2020, Kryeshefi Ekzekutiv i Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të energjisë elektrike të Kosovës (KOSTT) z.Illir M. Shala nënshkroi Memorandum Mirëkuptimi me Operatorin e Sistemit të Transmetimit të Zvicrës (SwissGrid).

Swissgrid si anëtar aktiv i Rrjetit të Operatorëve Evropianë të Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike (ENTSO-E) gjithashtu mban rolin e përgjegjës për Qendrën Koordinuese Jug, dhe në kuadër të këtij roli përmes Marrëveshjes së



nënshkruar do të mund të sigurojë asistencë teknike si dhe trajnim për punonjësit e KOSTT në fushën e Rregullimit të Frekuencës-Ngarkesës (LFC) si dhe zbatimin dhe funksionimin e Bllokut Rregullues.

“Kjo do të jetë një mundësi e shkëlqyer për operatorët tanë për zhvillim profesional dhe përgatitje për obligimet e reja, të cilat do t'i merr KOSTT-i së shpejti me fillimin e funksionimit të pavarur brenda Bllokut Rregullues Kosovë-Shqipëri dhe nënshkrimit të Marrëveshjes së re të Kycjes me ENTSO-E”, theksoi me këtë rast z.Shala.

Të dy kompanitë nënshkruese, mirëpresin shkëmbimin e njohurive që do të jenë në dobi të ndërsjellë si dhe do të jenë në funksion të mbështetjes së stabilitetit të përgjithshëm të rrjetit të transmetimit të energjisë elektrike në gjithë Evropën.



Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT, pjesë e panelit në uebinarin "Zbutja e efekteve të COVID-19 në ndërmarrjet e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Evropën Lindore"

Nën organizimin e Agjencionit Amerikan për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID), Edison Electric Institute nga Washington DC dhe USEA Energy Technology and Governance Program (ETAG), Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z.Illir M.Shala ishte pjesë a panelit diskutues në uebinarin me temë “Zbutja e efekteve të COVID-19 në ndërmarrjet e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Evropën Lindore”.

Në kuadër të uebinarit u prezentuan praktikat më të mira të menaxhimit në vazhdimësi të punës së ndërmarrjeve gjatë pandemisë COVID-19. Para më shumë se 125 pjesëmarrësve online nga vende të ndryshme të botës, z.Shala prezantoi masat e ndërmarra nga KOSTT për ruajtjen shëndetit të punonjësve gjatë periudhës së pandemisë si dhe masat që janë ndërmarrë për të siguruar operimin e sigurtë dhe të besueshëm të Sistemit të Transmetimit dhe Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës.



Nën moton EachforEqual, disa nga shumë gra të suksesshme të KOSTT flasin për rolin dhe sfidat e gruas në sektorin e energjisë

PËRFAQËSIMI I GRUAS NË KOSTT

Qasja në vendimmarrje

33.3%
të pozitive menaxheriale në KOSTT e përbëjnë femrat.



Shkollimi

31%
të punonjësve me shkollim të lartë janë femra.



347 Punonjës

16.1%
femra
83.9%
meshkuj



Në nivel global, numri i grave të kyçura në sektorin e energjisë është i ulët.

Inxhinier

25.5%
nga numri i përgjithshëm i inxhinierëve në KOSTT janë femra.



Qasja në zhvillim dhe trajnime

51.8%
e femrave në vitin 2019, janë përfshi në programe të ndryshme të trajnimit dhe zhvillimit.



Shërbimet e siguruara nga KOSTT janë qenësore për funksionimin e tërësishëm të Sistemit Elektroenergjetik të Republikës së Kosovës dhe me këtë, KOSTT mban rol të rëndësishëm në sigurinë e furnizimit.

Në përmbushjen e objektivave dhe performancën e suksesshme, rol thelbësor luajnë punonjësit e kompanisë dhe, në Ditën Ndërkombëtare të Gruas, KOSTT thekson përkushtimin për të drejta dhe trajtim të barabartë në mes të gjinive, përfaqësim dhe fuqizim të gruas. Njëkohësisht, shënojmë të arriturat shoqërore, ekonomike dhe profesionale të gruas.

KOSTT, si kompani e përkushtuar në CSR dhe zhvillim të qëndrueshëm, në drejtim të angazhimeve për të adresuar sfidat globale në kuadër të Agendës për Zhvillim të Qëndrueshëm 2030, është e orientuar ndër të tjera për të ndikuar në përmbushjen e Objektivës 5 për barazi gjinore SDG 5.

RESMIJE AHMA

Ju lutem për një përshkrim të shkurtër për vehten dhe rrugëtimin tuaj në sektorin e energjisë?

Përvojën mbi 30 vjeçare në sektorin e energjisë elektrike e kam filluar si inxhinieri për pajisjet RTU (Remote Terminal Unit) deri në vitin 2002, punë e cila ka qenë e lidhur ngushtë me pajisjet e instaluara nëpër nënstacione e të cilat në atë kohë kanë qenë të vjetra me mungesë të pjesëve rezervë por shumë të rëndësishme për funksionin e tyre. Punën dhe angazhimin në nivel të menaxhimit e kam ushtruar nga viti 2002 me pozitën Menaxhere e Departamentit për Sistemet Mbështetëse me përgjegjësi për sistemet si: SCADA, telekomunikime, matje të energjisë elektrike dhe TI. Nga viti 2006 deri në vitin 2018, Drejtore për Çështje Ligjore dhe Rregullative ndërsa nga muaji maj i vitit 2018 jam emëruar Drejtore në Departamentin e Shërbimeve Mbështetëse. Ky departament mbulon të gjitha aktivitetet që lidhen me sistemin SCADA / EMS, pajisjet SCS, sistemin për telekomunikime, teknologjinë e informacionit dhe komunikimit(TIK) si dhe çështjet e menaxhimit të ndërtesave të KOSTT.

Cili ka qenë motivi i juaj për të studiuar apo punuar në sektorin e energjisë?

Motivimi për të mësuar dhe për të vazhduar në një drejtim të caktuar ka filluar nga fjalët motivuese të mësueses, por motivimi me një efekt të fortë dhe të qëndrueshëm vazhdoi nga babai, duke më udhëzuar që shkolla e mesme teknike, drejtimi elektroteknikë është një bazë për studime në Universitetin e Prishtinës. Fjalët inkurajuese ishin “zhvillimet në elektroteknikë hapin perspektivë shumë vjeçare për inxhinieri”. Duke u nisur nga ky motivim, me përfundimin e studimeve në universitet kam realizuar synimet për përgatitje të lartë profesionale, punësim në sektorin e energjisë, ku edhe kam ëndërruar të punoj.

Ndonjë projekt i veçantë/apo angazhim specifik që e keni pasur gjatë karrierës profesionale dhe sfidat me të cilat jeni përballur si grua?

Projektet përbëjnë një instrument të rëndësishëm zhvillimor dhe në sektorin e energjisë elektrike janë bazë për çdo planifikim dhe zhvillim. Përvoja ime shumë vjeçare është e lidhur ngusht edhe me kontributin e drejtpërdrejt apo pjesërisht në shumë projekte zhvillimore dhe të infrastrukturës dhe në këtë rast dëshiroj të përmend projektin në vitet 2001-2002 për sektorin e energjisë të Kosovës ESTAP (Energy Sector Technical Assistance) i mbështetur nga Banka Botërore. Unë kam qenë e caktuar në atë kohë nga KEK përgjegjëse për Modulin E -vlerësimi i fizibilitetit të një sistemi të ri SCADA dhe rekomandimi i sistemit SCADA/EMS dhe pajisjet e ndërlidhura telekomunikuese dhe materialet, pajisjet dhe kostot e tyre të vlerësuara. Në atë kohë ne u përballëm me mungesë të njohurive për teknologji të reja, zhvillim të projekteve dhe mbingarkesë me angazhime profesionale. Pra, pozita e gruas në rastet kur detyrat e punës kërkojnë angazhim që lidhet me kufizim të kohës, paraqet një sfidë të cilën duhet tejkaluar me një angazhim maksimal gjatë orarit të punës dhe gjatë kohës



#EachforEqual

së lirë duke përfshirë edhe obligimet tjera familjare. Me një angazhim maksimal, bashkëpunim dhe punë ekipore me kolegët e përfshirë në këtë projekt të gjitha janë tejkaluar duke rezultuar me një projekt të suksesshëm dhe me shumë vlerë për zhvillimet që kanë pasuar në KOSTT.

Pse mendoni se është i rëndësishëm roli dhe kontributi i gruas në sektorin e energjisë, dhe çka mendoni se duhet ndërmarrë për të tërhequr më shumë femra në këtë sektor?

Roli i gruas në sektorin e energjisë duhet të vlerësohet duke marrë parasysh faktin se në të gjitha rastet kur janë përfshirë gratë, me angazhimin e tyre profesional apo me rolin udhëheqës, janë bërë ndryshimet që kanë dhënë rezultate pozitive. Këto suksese ndikojnë në motivimin e mëtutjeshëm të femrave për ngritjen e interesimit për të punuar në sektorin e energjisë.

Ju lutem për një mesazh inkurajues/inspirues për vajzat e reja për të punuar në sektorin e energjisë, apo mesazh për femrat në përgjithësi për t'u angazhuar për të drejtat e tyre, për përfaqësim dhe për marrjen e roleve udhëheqëse të merituar?

Inkurajoj të gjitha vajzat e reja të cilat kanë ambicie për studime dhe përgatitje profesionale, për të punuar në sektorin e energjisë, të marrin parasysh programet që janë duke u zhvilluar dhe duke u mbështetur nga projekte të ndryshme, të cilat ofrojnë mundësi fillimisht për t'u njohur me sektorin e energjisë të Kosovës e pastaj për punësim dhe krijim të një përvoje profesionale. Përvoja profesionale në çdo rast krijon përparësi për angazhim në vende të punës me më shumë përgjegjësi dhe profesionalizëm. Këto mundësi janë çdo ditë e më të mëdha, prandaj duhet të shfrytëzohen me angazhim dhe rezultate të mira.

SHUKRIJE FETAHAJ

Ju lutem për një përshkrim të shkurtër për vehten dhe rrugëtimin tuaj në sektorin e energjisë?

Menjëherë pas diplomimit në Fakultetin Elektroteknik u punësova si arsimtare në Shkollën e Mesme Teknike. Më vonë, në vitin 1989 aplikova në konkursin për Dispeçing (KEK), ku kërkoheshin tre inxhinier të elektroteknikës. U pranua dy meshkuj dhe unë femër. Pas periudhës praktike një vjeçare u pranova si dispeçere operative, por për shkak të masave të dhunshme të shpallura nga Serbia në Shtator të vitit 1990 u dëbuam nga vendet e punës deri pas luftës. Në vitin 1999 fillova përsëri në vendin e njejtë të punës për pesë vite, deri në vitin 2004. Në këtë vit u pranuan disa inxhinier të rinj dhe unë kalova si udhëheqëse e një sektori. Aktualisht udhëheqi sektorin për çështje rregullative në KOSTT.

Cili ka qenë motivi i juaj për të studiuar apo punuar në sektorin e energjisë?

Motivi i parë që më ka nxitë për të studiuar për inxhinieri ka qenë babai im. Ka qenë dëshirë e tij të ketë një fëmijë inxhinier dhe kështu ndoqa ëndrrën e tij duke përfunduar studimet dhe ishte vendosmëria ime për ta plotësuar dëshirën e babait për të punuar në sektorin e energjisë.

Ndonjë projekt i veçantë/apo angazhim specifik që e keni pasur gjatë karrierës profesionale dhe sfidat me të cilat jeni përballur si grua?

Periudha kur kam punuar si dispeçere ka pasur sfidat e saja duke marr parasysh që kam qenë e vetmja femër në rajon dhe në të njëjtën kohë ka pas një lloj presioni social që unë si femër po punoja me ndërrime të ditës dhe natës. Një rast i veçantë gjatë punës si dispeçere, ka qenë natën e ndërrimit të viteve 1999/2000. Më rastisi të punoja në ndërrimin e natës dhe kishim mungesë energjie për furnizimin dhe duhej të reduktonim ngarkesën në pjesë të ndryshme të Kosovës sipas orarit. Thirrnin qytetarët duke dhënë kritika nga më të ndryshmet: "si festohet nata e vitit të ri pa rrymë" ose "ti femër e me ma ndal mua rrymën", duke u potencuar kështu edhe më shumë stereotipet e shoqërisë tonë ndaj femrës në atë kohë.

Pse mendoni se është i rëndësishëm roli dhe kontributi i gruas në sektorin e energjisë, dhe çka mendoni se duhet ndërmarrë për të tërhequr më shumë femra në këtë sektor?

Gratë njihen globalisht si shtytëse të ndryshimit në zgjidhje të qëndrueshme në fushën e energjisë, ndryshimin e klimës dhe mbrojtjen e mjedisit. Gratë në Kosovë janë konsideruar si "ato që mbajnë shtëpinë" me dritë e energji pozitive që nga koha e ndezjes së qirinjve, tani më kemi mundësinë të tregojmë potencialin tonë, jashtë shtëpisë



#EachforEqual

tonë, në komunitetin ku jetojmë. Është e rëndësishme që të integrojmë perspektivën gjinore në politika, projekte dhe plane zhvillimore në fushat e ndryshme të energjisë si dhe në energjinë e ripërtëritshme. Zhvillimi i një shoqërie varet nga avancimi i gruas, pra edhe ne si shoqëri duhet të krijojmë kushte, fillimisht ti përkrahim me punë praktike, bursa për të studiuar në universitete ndërkombëtare e më pastaj edhe punësimin e sigurtë sipas tregut të punës.

Ju lutem për një mesazh inkurajues/inspirues për vajzat e reja për të punuar në sektorin e energjisë, apo mesazh për femrat në përgjithësi për t'u angazhuar për të drejtat e tyre, për përfaqësim dhe për marrjen e roleve udhëheqëse të merituar?

Siç dihet, në sektorin e energjisë pjesa më e madhe e të punësuarve janë burra dhe mesazhin që dua të jap për vajzat e reja është të mos e shikojnë një punë në sektorin e energjisë si barrierë, por përkundrazi të shohin rezultatet që vijnë nga kjo. Duke pasur më shumë femra në pozita udhëheqëse, sidomos në mjedise të korporatave ndikon në rritjen e produktivitetit, inovacion, vendimarrje më të mirë dhe ambient i punës më të mirë. Ajo që është e rëndësishme, mendoj që fillon që në fëmijëri në mënyrën se si ne e prezantojmë shkencën, sektorin e energjisë tek vajzat në shoqërinë tonë. Duhet të largojmë stereotipet gjinore në mënyrë që profesionet dhe fushat e ndryshme të promovohen njëjtë te të dyja gjinitë.

MAKFIRETE BINA

Ju lutem për një përshkrim të shkurtër për vehten dhe rrugëtimin tuaj në sektorin e energjisë?

Kam diplomuar në Fakultetin e Elektroteknikës në Universitetin e Prishtinës, Dega Energjetikë, ndërsa angazhimi im në sektor ka filluar që në vitet e 80-ta periudhë kjo kur në aspektin energjetik Kosova është zhvilluar mjaft shumë. Angazhimi im fillestar ka qenë si inxhinierë në mirëmbajtjen e nënstacioneve në Fabrikën për përpunimin e gomës (Rekord në Gjakovë) duke vazhduar në KEK fillimisht si inxhinierë për planifikim dhe analizë të Sistemit Elektroenergjetik të Kosovës dhe nga viti 2004 si menaxhere e projekteve. Nga viti 2006 udhëheq sektorin për implementim të projekteve në KOSTT.

Cili ka qenë motivi i juaj për të studiuar apo punuar në sektorin e energjisë?

Shkolla e mesme Teknike "Nexhmedin Nixha" në Gjakovë ku unë përfundova shkollën ishte shkolla e parë që u hap në atë kohë në lëmitë teknike në Gjakovë dhe njohuritë dhe përvoja që e fitova aty më motivuan për të vazhduar edhe me studimet në Fakultetin e Elektroteknikës dega Energjetikë. Sektori i Energjisë ka qenë një oazë për inxhinierët e ri në kohën kur unë e kam kryer fakultetin në fillim të viteve 80 -të dhe është llogarit si profesion deficitar në Kosovë.

Ndonjë projekt i veçantë/apo angazhim specifik që e keni pasur gjatë karrierës profesionale dhe sfidat me të cilat jeni përballur si grua?

Të gjitha projektet kanë një veçanti në vetvete dhe të gjithë janë sfidues në mënyrën e vet por Projekti më i veçantë dhe më i vështirë në implementim ka qenë "Rehabilitimi i Nënstacionit Kosova A" sepse për shkak të kompleksitetit ka qenë sfidë e vërtetë për ta menaxhuar dhe për ta realizuar me zero aksidente. Në vetvete ngërthente shumë fusha si ato: gjeneratorike, transformatorike si dhe fusha të linjave duke përfshi edhe nivele të ndryshme të tensioneve.

Pse mendoni se është i rëndësishëm roli dhe kontributi i gruas në sektorin e energjisë, dhe çka mendoni se duhet ndërmarrë për të tërhequr më shumë femra në këtë sektor?

Profesioni nuk ka gjini, femra inxhinierë nuk ka dallim nga mashkulli inxhinier, edhe pse ka paragjykime në tërë botën dhe ka diskriminim në tregun e punës, këtë diskriminim e kemi diskutuar me femrat e inxhinierë që i ka Evropa e sotshme kur jemi takuar gjatë testimeve të pajisjeve të cilat i kemi montuar në Nënstacionet tona. Ndihej e privilegjuar që pata mundësinë të menaxhoj shumë projekte kapitale të



#EachforEqual

investuara nga donatorë të ndryshëm dhe Qeveritë e shteteve të Evropës si DANIDA, DIFID, USAID, EU, KFW si dhe së fundmi nga BERZH. Gjithashtu kam qenë e angazhuar edhe në projektin e programit të Qeverisë së Kosovës PIP (Programi i Investimeve Publike).

Ju lutem për një mesazh inkurajues/inspirues për vajzat e reja për të punuar në sektorin e energjisë, apo mesazh për femrat në përgjithësi për t'u angazhuar për të drejtat e tyre, për përfaqësim dhe për marrjen e roleve udhëheqëse të merituar?

Mesazhi im është "mësoni dhe bëhuni të ditura sepse dija as nuk shitet e as nuk blihet, pra dijen e ndërton njeriu gjatë jetës së tij, duke i përcaktuar vet caqet të cilat do ti mbërrij në jetë, por shkenca t'i hap të gjitha dyert e diturisë dhe të ofron të mira materiale që do ta lehtësojnë jetën përgjithmonë."

Të njëjtin mesazh e kam dhënë edhe për vajzat e reja nëpër shkollat e mesme teknike dhe në gjimnaze përmes projektit STEM të realizuar nga Shoqata e Grave në Sektorin e Energjisë në Kosovë përmes së cilës e japim kontributin dhe njohuritë tona profesionale shumë gra të sektorit të energjisë në promovimin e punës në këtë fushë. Të vjetrit kanë thënë "një grua e ditur dhe e mençur vlen sa dy kuaj të mbushur me florinj".

ASTRITE NEZIRI

Ju lutem për një përshkrim të shkurtër për vehten dhe rrugëtimin tuaj në sektorin e energjisë?

Kam diplomuar në Fakultetin Elektroteknik, drejtimi Sistemet Elektroenergjetike. Në vitin 2002 pata fatin të angazhohem në projektin e financuar nga Banka Botërore, ESTAP (Energy Sector Technical Assistance Project). Trajnimet që i mora deri në përfundimin e projektit, periudha njëvjeçare, më shërbyen shumë dhe njohuritë që i mora i aplikova në punën time si inxhinier Specialiste Për Zhvillim të Sistemit dhe Planifikim Afatgjatë.

Duke qenë në këtë pozitë, pasi që sistemet elektroenergjetike janë të ndërlidhura përmes linjave interkonektive, atëherë edhe bashkëpunimi ndërmjet OST-ve rajonale është i pashmangshëm. Kam nderin dhe ndjem e privilegjuar që KOSTT ma ka besuar përfaqësimin e kompanisë në disa grupe punuese regjionale ku analizohet modeli i integruar i rrjetit transmetues të Evropës juglindore, pjesë e të cilit rrjet është edhe rrjeti i transmetimit të Kosovës, në aspektin e planifikimit dhe zhvillimit afatgjatë. Përfaqësimin e KOSTT-it nuk e marr vetëm si privilegj por e konsideroj si përgjegjësi pasi që nuk e përfaqësoj vetëm kompaninë që i takoj, por e përfaqësoj edhe femrën inxhinierë të vendit tim.

Cili ka qenë motivi i juaj për të studiuar apo punuar në sektorin e energjisë?

Kur unë përfundova shkollën e mesme, për nxënësit e shkëlqyeshëm ishte krenari ta sfidoje vehten në fakultete që konsideroheshin më të vështira, siç ishte edhe Fakulteti Elektroteknik. Pasi përfundova me sukses të shkëlqyeshëm gjimnazin shkencor në Pejë drejtimi matematikor, me mbështetjen e familjes dhe me shtytjen e vëllezërve të mi, që edhe ata studionin në fakultete teknike, por jo në lëmin e inxhinierisë elektrike, vendosa të regjistrohem në Fakultetin Elektroteknik, drejtimi Sistemet Elektroenergjetike, gjenerata 1990-1991.

Ndonjë projekt i veçantë/apo angazhim specifik që e keni pasur gjatë karrierës profesionale dhe sfidat me të cilat jeni përballur si grua?

Jo vetem në sektorin e energjisë por për çdo grua që vendos të bëjë karrierë, e veçanërisht kur je nënë përballesh me sfida të ndryshme, sfida këto që nuk do të thotë se janë në aspektin e shkeljes në baza gjinore, por të natyrës që familja e veçanërisht fëmijet e vuajn mungesën e nënës në shtëpi. Më kujtohet në fillim të karrierës në vitin 2002, pasi që u angazhova në projektin ESTAP, ishte projekt ku ishin të angazhuar ekspert ndërkombëtar për analizën, modelimin dhe planifikimin afatgjatë të Sistemit Elektroenergjetik të Kosovës. Për mua si nënë e re ka qenë shumë sfiduese të vendos në mes të punës dhe vijimit të trajnimeve që bëheshin në kuadër të projektit dhe kujdesit për djalin që ishte vetem 3 muaj. Por me mbështetjen e familjes dhe për hir të karrierës unë zgjodha të vazhdoj punën edhe atë me orar të plotë. Kjo ka qenë për mua periudha më sfiduese që edhe sot e kësaj dite kur flas kam emocione dhe më ka mbetur si peng, dmth në njëfarë mënyre me sakrifiku dashurinë dhe kujdesin për foshnjën për fillimin e ndërtimit të karrierës.



#EachforEqual

Pse mendoni se është i rëndësishëm roli dhe kontributi i gruas në sektorin e energjisë, dhe çka mendoni se duhet ndërmarrë për të tërhequr më shumë femra në këtë sektor?

Sektori i energjisë dominohet kryesisht nga gjinia mashkullore, por duke pasur të angazhuara edhe mjaft gra inxhinierë të suksesshme dhe që e zotërojnë mirë profesionin e tyre, veçse janë thyer paragjykimet që i ndajnë profesionet në baza gjinore. Për më tepër, unë mendoj se disa punë edhe menaxhohohen më mirë nga gratë si: organizimi, planifikimi, eficientia e energjisë, etj.

Ju lutem për një mesazh inkurajues/inspirues për vajzat e reja për të punuar në sektorin e energjisë, apo mesazh për femrat në përgjithësi për t'u angazhuar për të drejtat e tyre, për përfaqësim dhe për marrjen e roleve udhëheqëse të merituar?

Mesazhi im për vajzat e reja, jo vetem për sektorin e energjisë, por kudo që ato e shofin veten, punoni shumë dhe me perkushtim që ta zotëroni profesionin që ju e zgjedhni, vetëm me punë dhe perkushtim i theni barrierat dhe paragjykimet që fatkeqësisht akoma shoqëria jonë i ka për gjininë femrore. Ka rendesi jetike që femrat të bëhen ekonomikisht të pavarura, sepse vetëm të pavarura mund ti shërbejnë në rend të parë mirëqenies së tyre, familjes dhe shoqërisë në përgjithësi. As një profesion nuk është i lehtë për tu mbajtur, krahas të qenurit edhe nënë, edhe grua, kur dihet që në shoqërinë tonë pjesa më e madhe e punëve që kryhen brenda familjes mbulohen nga gratë, por nëse jeni të vendosura, të jeni të sigurt që mund t'ia arrini qëllimit.

ELFIJE SADIKU

Ju lutem për një përshkrim të shkurtër për vehten dhe rrugëtimin tuaj në sektorin e energjisë?

Punësimi im në sektorin e energjisë përfshin një periudhë 32 vjeçare. Me profesion jam ekonomiste dhe në KOSTT punoj si specialiste për trezor në Departamentin e Financave. Ndihem shumë e privilegjuar që unë e jap kontributin tim për KOSTT, ku si shtytje për një punë të palodhshme na jep menaxhmenti i lartë, që na inkurajon dhe na vlerësojnë për punën që ne e kryejmë.

Cili ka qenë motivi i juaj për të studiuar apo punuar në sektorin e energjisë?

Sektori i energjisë është faktor kyç i zhvillimit ekonomik, andaj edhe mundësia për tu zhvilluar është më e madhe dhe më premtuese. Për këtë arsye pozicionimi im në këtë sektor është si rrjedhojë e të mirave të lartpërmendura.

Ndonjë projekt i veçantë/apo angazhim specifik që e keni pasur gjatë karrierës profesionale dhe sfidat me të cilat jeni përballur si grua?

Fatmirësisht, në KOSTT nuk ka dallime sa i përket gjinisë. Në Departamentin e Financave vazhdimisht kam pasur mbështetjen e menaxhmentit. Sfidat me të cilat ballafaqohemi janë të natyrës së punës, andaj me mbështetjen të vazhdueshme, me profesionalizmin që kemi dhe me punën ekipore, të gjitha këto sfida janë të tejkalueshme dhe pa pengesa në punë.

Pse mendoni se është i rëndësishëm roli dhe kontributi i gruas në sektorin e energjisë, dhe çka mendoni se duhet ndërmarrë për të tërhequr më shumë femra në këtë sektor?

Gratë përbëjnë grupin shoqëror më të rëndësishëm në segmentin e zhvillimit ekonomik. Meqenëse energjia është duke u rritur si burim i ekonomisë në mbarë botën, e veçanërisht në Kosovë, me ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese, gratë do të jenë potencial real ekonomik në këtë fushë. Me këtë rast vendosja e aspektit mbi barazinë gjinore në planifikimin e politikave të energjisë, është më se e nevojshme.



#EachforEqual

Ju lutem për një mesazh inkurajues/inspirues për vajzat e reja për të punuar në sektorin e energjisë, apo mesazh për femrat në përgjithësi për t'u angazhuar për të drejtat e tyre, për përfaqësim dhe për marrjen e roleve udhëheqëse të merituar?

I inkurajoj të gjitha fmerat që të angazhohen për të drejtat e tyre dhe përfaqësim sepse "Gratë nuk janë numër, por ato përfaqësojnë gati se gjysmën e popullsisë globale".



Përmbillet me sukses votimi i Marrëveshjes së re të Kçjes KOSTT/ENTSO-E

Me datë 20 prill 2020 u përbyll me sukses votimi i Marrëveshjes së re të Kçjes në mes të KOSTT dhe ENTSO-E, nga Grupi Regjional i Evropës Kontinentale (RGCE).

Me votimin dhe nënshkrimin që do të pasoj, KOSTT dhe Republika e Kosovës përfundimisht del nga Blloku rregullues SMM (Serbi, Mali i Zi dhe Maqedoni Veriore) dhe i bashkohet Bllokut Rregullues të Sistemeve Energjetike Kosovë-Shqipëri-Blloku AK.

Me fillimin e implemenimit të Marrëveshjes së re të Kçjes në mes të KOSTT dhe ENTSO-E, KOSTT do të operoj si zonë rregulluese e pavarur brenda Bllokut AK në kuadër të zonës sinkrone të Evropës Kontinentale. Alokimi i kapaciteteve të interkoneksionit dhe menaxhimi i kongjestionave të rrjetit interkonektiv do të realizohet brenda strukturës së këtij blloku dhe jo më nga EMS (Serbi), ku edhe të hyrat nga këto aktivitete do të mblidhen nga Blloku, përkatësisht nga KOSTT. Ky zhvillim tutje i hap rrugë KOSTT-it për integrimin

në tregun rajonal të energjisë, pjesëmarrjes në bursën shqiptare të energjisë (APEX) si dhe vënies në operim të linjës 400 kV Kosovë-Shqipëri.

Pas përmbilljes së procesit të votimit, Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z.Illir M.Shala theksoi “Pas një pune të shkëlqyeshme nga ekipi i ekspertëve të KOSTT për disa vite me radhë, siç edhe patëm paralajmëruar, ne sot me 20 prill 2020 angazhimin tonë të pakursyer e kurorëzuar me fitore. Kjo, është një ditë e madhe historike për KOSTT-in dhe për gjithë Kosovën. Me zhvillimet e sotshme, edhe në aspektin energjetik KOSTT dhe Republika e Kosovës pavarësohen nga Serbia.”

KOSTT sh.a falëndroi për mbështetjen institucionet shtetërore të Republikës së Kosovës, ZRrE, Ambasadën Gjermane, Bankën gjermane për Zhvillim-KfW, Ambasadën Amerikane, USAID, kompanitë homologe të ENTSO-E dhe të gjitha palët e tjera të interesit vendore dhe ndërkombëtare për përkrahjen e vazhdueshme në këto procese.



KOSTT

Kryeministri i Kosovës në detyrë z.Albin Kurti vizitoi KOSTT-in, pas suksesit të arritur me votimin e Marrëveshjes së re të Kyçjes KOSTT/ENTSO-E

Me datë 21 Prill 2020, në ambientet e ndërtesës qendrore të KOSTT, menaxhmenti në krye me Kryeshefin Ekzekutiv z.Illir M. Shala, pritën në takim Kryeministrin e Kosovës në detyrë z.Albin Kurti dhe Ministren në detyrë të Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike znj.Rozeta Hajdari me bashkë-punëtorë.



E. Krasniqi për KOSTT

Me këtë rast z.Shala njoftoi delegacionin qeveritar për së afërmi në lidhje me procesin e votimit të datës 20 Prill 2020 të Marrëveshjes së re të Kyçjes në mes të KOSTT dhe ENTSO-E, nga ana e Operatorëve të Sistemit të Transmetimit (OST) të vendeve të Grupit Regjional të Evropës Kontinentale (RGCE), trup i ENTSO-E. Sipas z.Shala, pas nënshkrimit në javët në vijim, Marrëveshja e re e Kyçjes KOSTT/ENTSO-E do të hyj në fuqi me datë 15 maj 2020. Ai sqaroi që me këtë zhvillim tani KOSTT-it dhe Republikës së Kosovës



E. Krasniqi për KOSTT



E. Krasniqi për KOSTT

do t'i njihen kufijt energjetik si zonë rregulluese brenda Bllokut Rregullues AK me Republikën e Shqipërisë. Tutje ai njoftoi që devijimet ndaj rrjetit ndërkombëtar evropian për shak të furnizimit të veriut të Kosovës do të ndërprehen.

Kryeministri në detyrë Kurti përgëzoi KOSTT-in për suksesin e madh që është arritur me datë 20 Prill 2020, me pavarësimin elektro-energjetik të Kosovës dhe bërjen e KOSTT operator me të drejta të barabarta me homologët e tjerë evropian.

Delegacioni qeveritar u njoftuan që me hyrjen në fuqi të Marrëveshjes, alokimi i kapaciteteve të interkoneksionit dhe menaxhimi i kongjes-tioneve të rrjetit interkonektiv të Kosovës do të realizohet brenda strukturës së Bllokut Rregullues AK dhe jo më nga EMS (Serbi), ku edhe të hyrat nga këto aktivitete do të mblidhen nga Blloku, përkatësisht nga KOSTT. Ky zhvillim tutje i hap rrugë KOSTT-it për integrimin në tregun rajonal të energjisë, pjesëmarrjes në bursën shqiptare të energjisë (APEX) si dhe vënies në operim të linjës 400 kV Kosovë-Shqipëri. Kryeministri në detyrë Kurti shprehu përkrahjen për KOSTT për të gjitha këto procese të pritura në vijim.

Delegacioni qeveritar gjithashtu vizituan edhe Qendrën Nacionale Dispeçerike në KOSTT prej nga u njoftuan rreth operimit në kohë reale të Sistemit të Transmetimit të Republikës së Kosovës.

Ambasadori i Republikës së Shqipërisë z.Qemal Minxhozi vizitoi KOSTT-in

Në vazhden e vlerësimeve të suksesit të arritur në votimin e Marrëveshjes së re të Kyçjes në mes të KOSTT dhe ENTSO-E, me 22 prill 2020 Ambasadori i Republikës së Shqipërisë z.Qemal Minxhozi vizitoi KOSTT-in, ku u prit nga Kryeshefi Ekzekutiv z.Illir M.Shala me bashkëpunëtorë.

Në kuadër të vizitës, menaxhmenti i KOSTT e njoftuan nga afër ambasadorin Minxhozi me suksesin e arritur në këtë drejtim si dhe hapat e më tutjeshëm drejt konkretizimit të marrëveshjeve të nënshkruara dhe zbatimin e iniciativave të përbashkëta me Operatorin e Sistemit të Transmetimit Shqiptar (OST).



KOSTT

“Ky ishte çelësi i cili neve si KOSTT do të na mundësojë që të operojmë me të gjitha të drejtat e barabarta që na takojnë si Operator i Sistemit të Transmetimit, sipas standardeve evropiane për operim. Ne do të vazhdojmë tutje me implementimin e projekteve, siç janë: vënia në operim e linjës 400 kV Kosovë-Shqipëri projekt kapital i cili u bashkë financua me Qeverinë Gjermane përmes Bankës Gjermane për Zhvillim (KfW),



KOSTT

operacionalizimi i Bllokut Rregullues të Sistemeve Energjetike Kosovë-Shqipëri (Blloku AK), zbatimi i tregut të përbashkët të energjisë elektrike Kosovë-Shqipëri si dhe pjesëmarrja e KOSTT-it në Bursën Shqiptare të Energjisë, e njohur si APEX”, theksoi z.Shala.

Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT-it me bashkëpunëtorë, shprehën falënderimet e sinqerta për mbështetjen e vazhdueshme në këto procese të rëndësishme nga ana e Republikës së Shqipërisë dhe në veçanti për bashkëpunimin e frytshëm me homologët në OST Shqipëri.

Në anën e tij Ambasadori i Shqipërisë z. Minxhozi përgëzoi Grupin Punues dhe gjithë punonjësit e KOSTT-it, për suksesin e arritur në votimin e Marrëveshjes së re të Kyçjes në mes të KOSTT dhe ENTSO-E. Ambasadori shprehu mbështetjen e më tutjeshme në proceset bashkëpunuese që pasojnë në mes të dy vendeve si dhe mirëpriti gatishmërinë për futjen në operim të plotë të linjës 400 kV Kosovë – Shqipëri, me hyrjen në fuqi të Marrëveshjes së Kyçjes, që është me interes si për sigurinë e furnizimit me energji elektrike ashtu dhe për sigurinë dhe besueshmërinë e sistemeve elektroenergjetike të Kosovës, Shqipërisë dhe rajonit në përgjithësi.

Kryetarja e Kuvendit të Kosovës znj.Vjosa Osmani, priti në takim menaxhmentin e lartë të KOSTT, pas suksesit në votimin e Marrëveshjes së re të Kyçjes KOSTT/ENTSO-E

Në ambientet e Kuvendit të Kosovës me datë 22 prill 2020 Kryetarja e Kuvendit znj.Vjosa Osmani priti në takim Kryeshefin Ekzekutiv të KOSTT z.Illir M.Shala me bashkëpunëtorë. Me këtë rast Kryetarja Osmani ka përgëzuar KOSTT-in për votimin pozitiv të Marrëveshjes së re të Kyçjes me ENTSO-E dhe theksoi se “votimi pozitiv për marrëveshjen e re të kyçjes nga ana e Operatorëve të Sistemeve të Transmisionit të Evropës (që operojnë brenda asociacionit ENTSO-E), është një hap historik për vendin, e sidomos një zhvillim tejet pozitiv për zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit të energjisë.”

Menaxhmenti i KOSTT ka falënderuar Kuvendin e Kosovës për bashkëpunimin si dhe të dy institucionet u dakorduan për koordinim në hapat e mëtejshëm që do të ndërmerren.



Foto Credit Kuvendi i Kosovës

z.Shala dhe znj.Osmani gjithashtu diskutuan edhe për mbarëvajtjen e proceseve të operimit dhe menaxhimit të kompanisë. Sipas Ligjit për energjinë elektrike nga viti 2016, të drejtat e aksionarit të KOSTT sh.a ushtrohen përmes Kuvendit të Republikës së Kosovës.




Foto Credit Kuvendi i Kosovës

Mbahet ligjerata online "Menaxhimi i Burimeve Njerëzore"

KOSTT sh.a, është kompania e parë publike, e cila ka filluar implementimin e Programit të Leadershipit inicuar nga menaxhmenti i lartë, në vazhden e realizimit të objektivave të kompanisë dhe ndërtimit të kulturës, guximit dhe besimit për krijimin dhe zhvillimin e liderëve të rinj.

Në kuadër të këtij programi, me 30 prill u mbajt ligjerata online me temën "Menaxhimi i Burimeve Njerëzore" nga Skender Nushi (Menaxher i Burimeve Njerëzore – Zyra Regjionale e UNICEF për Evropë dhe Azi Qendrore).

Në këtë ligjeratë morën pjesë i gjithë grupi i Programit të Leadershipit dhe e veçanta e këtij grupi prej 10 vetash është se 50 % janë gra dhe 50 % burra.



Menaxhmenti i KOSTT priti në takim përfaqësuesit e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë

Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z.Illir M.Shala me bashkëpunëtorë, me 7 maj 2020 pritën në takim përfaqësuesit e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, udhëhequr nga u.d. Kryesuesi i Bordit z.Arsim Janova.

Menaxhmenti i KOSTT njoftuan nga afër përfaqësuesit e ZRrE në lidhje me procesin e votimit të Marrëveshjes së re të Kyçjes në mes të KOSTT dhe ENTSO-E dhe përgatitjet nga ana e KOSTT për fillimin e operimit si zonë e pavarur rregulluese në kuadër të Bllokut Rregullues AK, me hyrjen në fuqi të Marrëveshjes në fjalë.

Në takim gjithashtu u diskutua edhe rreth funksionimit, stabilitetit dhe qëndrueshmërisë financiare të sektorit të energjisë në Kosovë në situatën aktuale të përmballjes me pandeminë COVID-19, me ç'rast z.Shala njoftoi ZRrE-në rreth menaxhimit të suksesshëm të situatës përmes masave, që janë ndërmarrë për të mbrojtur



shëndetin e punonjësve si dhe për të siguruar funksionimin e sigurt dhe stabil të Sistemit të Transmetimit të Republikës së Kosovës, në përputhje me kërkesat dhe rekomandimet e insitucioneve shtetërore dhe shëndetësore për parandalimin e përhapjes së coronavirusit.

Me këtë rast, Bordi i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë në krye me z.Janova përgëzoi KOSTT-in për suksesin e arritur në votimin e Marrëveshjes së Kyçjes KOSTT/ENTSO-E.

Mobilizimi i KOSTT në shërbim të sigurisë së furnizimit me energji elektrike dhe luftimin e përhapjes së COVID-19

Shërbimet e siguruara nga KOSTT janë qenësore për funksionimin e tërësishëm të Sistemit Elektroenergetik të Republikës së Kosovës dhe me këtë, KOSTT mban rol të rëndësishëm në sigurinë e furnizimit me energji elektrike.

- Organizimin e punës me ndërrime për funksionet esenciale
- Organizimin e punës nga shtëpia



Për të siguruar funksionimin e sigurt dhe stabil të sistemit të transmetimit dhe operimin e tregut të energjisë elektrike në përputhje me kërkesat dhe rekomandimet e institucioneve shtetërore dhe shëndetësore për parandalimin e përhapjes së #coronavirus COVID19, KOSTT ka ndërmarrë:

- Masat e nevojshme për të mbrojtur shëndetin e punonjësve në detyrë në ambientet e brendshme të punës dhe në terren
- Masat e nevojshme për të garantuar punën 24/7 të Qendrës Nacionale Dispečerike dhe të Nën-stacioneve të KOSTT në mbarë Kosovën
- Dezinfektimin e vazhdueshëm të ambienteve të punës në të gjitha objektet dhe pajisjen me mjete mbrojtëse higjienike
- Organizimin e ekipeve kujdestare për intervenimet e nevojshme në terren

Menaxhmenti i KOSTT gjithashtu në baza të rregullta ishte në koordinim dhe bashkëpunim të vazhdueshëm me të gjitha institucionet e sektorit të energjisë në vend

Të gjithë të mobilizuar në shërbim të sigurisë së furnizimit me energji elektrike dhe luftimin e përhapjes së COVID-19

